

A close-up photograph of a green leaf with several water droplets of various sizes. The droplets are in sharp focus, showing their spherical shape and the way they reflect light. The leaf's veins are visible in the background, which is slightly blurred.

Transparency Report 2024

RSM Kosovo sh.p.k.

PËRMBAJTJA

	Faqe
<u>Mesazh nga Partneri Menaxhues</u>	3
<u>Struktura ligjore dhe pronësia</u>	4
<u>Rrjeti i RSM International</u>	8
<u>Sistemi i kontrollit të brendshëm</u>	11
<u>Edukimi i vazhdueshëm profesional, rekrutimi dhe zhvillimi personal</u>	21
<u>Kompensimi i partnerëve</u>	23
<u>Auditimi i subjekteve me interes publik</u>	24
<u>Shënimet financiare</u>	25
<u>Shtojcat</u>	26

Mesazh nga partneri menaxhues

RSM Kosovo Sh.p.k me kënaqësi paraqet Raportin e Transparencës për vitin financiar që përfundoi më 31 dhjetor 2024 i cili është përgatitur në përputhje me kërkesat e nenit 10 të Ligjit Nr. 06/ L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 3 i datës 19 Prill 2018.

Në një mjedis biznesi që ndryshon me shpejtësi, besimi, transparenca dhe integriteti janë më të rëndësishme se kurrë. Ky raport vjetor pasqyron përkushtimin tonë të vazhdueshëm për të ofruar shërbime profesionale të bazuara në cilësi dhe etikë. Ai njëkohësisht dëshmon përpjekjet tona të vazhdueshme për të promovuar qeverisje të mirë, zhvillim të brendshëm dhe përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Ky raport paraqet jo vetëm proceset dhe strukturat që kemi ndërtuar për të mbështetur auditime cilësore, por edhe përpjekjet tona të vazhdueshme për të zhvilluar talente, për të investuar në teknologji, dhe kultivimin e një mjedisi pune që nxit rritje profesionale dhe angazhim afatgjatë.

Këtë vit shënojmë jo vetëm edicionin e gjashtë të këtij raporti, por edhe vitin e nëntë si pjesë e rrjetit global të RSM. Është një moment i rëndësishëm për të shprehur mirënjohjen më të sinqertë për klientët tanë, që na kanë besuar si partnerë strategjikë në rrugëtimin e tyre.

Faleminderit që na besoni si partnerë në zhvillimin tuaj dhe që ndani me ne sfidat dhe sukseset. Është pikërisht kjo marrëdhënie e ndërtuar mbi respekt, bashkëpunim dhe mirëkuptim të ndërsjellë ajo që na motivon të rritemi vazhdimisht.

Falënderime të veçanta edhe për ekipin tonë, të cilët me përkushtim të palodhur, integritet dhe pasion, përfaqësojnë çdo ditë vlerat thelbësore të RSM. Suksesi ynë është rezultat i përpjekjeve kolektive dhe i kulturës sonë të bashkëpunimit dhe inovacionit.

Si pjesë e një rrjeti ndërkombëtar që promovon besimin përmes fuqisë së të kuptuarit, ne jemi të përkushtuar në ndërtimin e partneriteteve të qëndrueshme dhe të krijojmë vlerë reale përmes identifikimit të nevojave të klientëve tanë, sfidave të tregut dhe ndikimit pozitiv në komunitet.

Ndërsa ecim përpara, jemi të vendosur të ruajmë standardet më të larta profesionale dhe të vazhdojmë ta udhëheqim këtë rrugëtim me përgjegjshmëri dhe vizion të qartë.



Visar Morina
Partner Menaxhues

30 prill 2025

Struktura Ligjore dhe Pronësia

RSM Kosovo SH.P.K. ("Kompania") është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Republikën e Kosovës më 18 Prill 2016 me numër unik identifikues 810861254. Adresa e regjistruar e selisë është Rruga Xhevdet Doda Dukagjini Residence, Hyrja B-C, Kati 2, nr. B56, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Më 31 dhjetor 2024, kompania punëson gjithsej 28 punëtorë profesional. Kompania ka një staf të kualifikuar dhe me eksperienc shumëvjeqare në profesion.

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024, struktura e pronësisë është si vijon:

- Sadik Berisha – Auditor Ligjor, banor i Republikës së Kosovës, zotëron 51%,
- Kujtim Berisha – individ, banor i Republikës së Kosovës, zotëron 48%, dhe
- Valbona Hamiti – Auditor Ligjor, banor i Republikës së Kosovës, zotëron 1%.


Përderisa Bordi i Partnerëve dhe Drejtorëve të Kompanisë është në përbërje si në vijim:

- Visar Morina – Partner Menaxhues,
- Sadik Berisha – Kryesues i bordit,
- Kujtim Berisha – Anëtar i bordit,
- Valbona Hamiti – Anëtar bordi,



Vlerat tona

Çdo vendim që marrim udhëhiqet nga vlerat tona. Ato janë themeli i gjithçkaje që bëjmë:



RESPEKT DHE INTEGRITET I PAKOMPROMIS

Ne bëjmë gjënë e duhur,
duke u siguruar që
veprimet tona flasin më
fort se fjalët.



SUKSES SË BASHKU

Ne përqafojmë përfshirjen
dhe individualitetin, dhe
bashkëpunojmë në mënyrë
efektive për të ndërtuar
marrëdhënie të forta bazuar
në mirëkuptim të thellë.



EKSELENCË

Ne fokusojmë
vazhdimisht në cilësi dhe
përpqemi të jemi më të
mirët në gjithçka që
bëjmë, si individë dhe si
ekip.



INOVACION ME NDIKIM

Ne mirëpresim ndryshimin
dhe përdorim njohuritë dhe
teknologjinë për të bërë një
ndryshim të vërtetë për
klientët dhe njerëzit tanë.



VEPRIM ME PËRGJEGJËSI

Ne ndërtojmë një të ardhme
më të mirë duke treguar
përgjegjësi ndaj njerëzve
tanë, klientëve,
komuniteteve dhe planetit.

Qasja jonë

Të gjithë klientët tanë kërkojnë standarde të larta të dorëzuara në një qasje me kosto efektive. Ne krenohemi me ofrimin e shërbimeve shumë profesionale, efikase për klientët tanë dhe inkurajimin e marrëdhënieve reciproke të dobishme me klientët tanë dhe këshilltarët e tyre.


Qëllimi ynë është të zhvillojmë bashkëpunim afatgjatë me klientët tanë, këshilltarët dhe palët me interes që angazhojmë.

Qasja jonë përqendrohet në:

- marrjen e një qasje profesionale në shërbimet që ne ofrojmë;
- adoptimin e një qasjeje fleksibile për plotësimin e nevojave të klientit;
- pavarësinë e plotë nga lidhjet institucionale; dhe
- zhvillimin e marrëdhënieve afatgjatë bazuar në themelet e forta personale që ne ndërtojmë me klientët dhe këshilltarët tanë.

Ne kemi zhvilluar një gamë të gjërë dhe fleksibile të aftësive, të cilat na lejon të shtojmë vlerë në punët e klientëve tanë duke:

- dëgjuar klientët, kuptuar objektivat e tyre dhe ofrimin e zgjidhjeve efektive dhe inovative;
- caktuar një ekip të stafit profesional, nën drejtimin e një partneri, më të përshtatshëm për aftësitë e kërkuara nga klienti, mirëmbajtjen e këtij ekipi dhe rritjen e tij sipas nevojës gjatë gjithë marrëdhënies së punës;
- respektuar dhe përmbushur afatet dhe kërkesat e raportimit; dhe
- ofruar tarifa reale me një strukturë fleksibile të ngarkimit dhe ndihmuese në kërkimin e zgjidhjeve me kosto efektive.



Fuqia e të Qenurit të Kuptuar / The Power of Being Understood

Fuqia e të Qenurit të Kuptuar është një premtim që u bëjmë klientëve tanë dhe njerëzve tanë se, kur punojnë me RSM, ata bashkëpunojnë me profesionistë që marrin kohën për t'i kuptuar thellësisht, që sjellin ide dhe njohuri të përshtatshme për rrethanat e tyre, dhe që janë të përkushtuar t'i ndihmojnë të marrin vendime të sigurt për të ardhmen e tyre.

Për të krijuar përvoja që na veçojnë nga të tjerët, ne në RSM inkurajojmë dhe shpërblejmë sjelljet thelbësore në vijim të njerëzit tanë:

Përkujdesje Ne tregojmë kujdes të sinqertë dhe dhembshuri ndaj klientëve dhe kolegëve tanë, duke mbështetur nevojat dhe sfidat e tyre unike.	Kureshtje profesionale Ne bëjmë pyetje thelbësore dhe kërkojmë perspektiva të ndryshme për të kuptuar më mirë, për të sfiduar mënyrën e të menduarit dhe për të gjeneruar ide të reja.	Bashkëpunim Ne punojmë ngushtë me të tjerët, ndajmë njohuri dhe ndërtojmë marrëdhënie të forta për të arritur rezultate të përbashkëta.
Guxim Ne marrim iniciativa, sfidojmë status quo-në dhe veprojmë me integritet, edhe në situata të vështira, për të bërë zgjedhjet e duhura.	Mendim Kritik Ne analizojmë thellësisht situatat, shtrojmë pyetje të menduara dhe marrim vendime të bazuara në të dhëna që sjellin vlera afatgjate.	

Rrjeti RSM International

RSM është një rrjet ndërkombëtar i firmave profesionale të pavarura, i formuar në fillim të viteve 1960.

RSM International Limited është një kompani e kufizuar me garanci dhe është përfshirë në Angli dhe Uells (numri i kompanisë: 4040598) dhe zyra e regjistruar e së cilës është në 50, Cannon Street, London, EC4N 6JJ.

RSM International Limited nuk ofron vetë shërbime profesionale për klientët, por vepron si një organizatë e shërbimeve anëtare. Shërbimet e klientëve ofrohen nga firmat anëtare të pavarura të RSM International, secila prej firmave anëtare është një entitet juridik i veçantë dhe i pavarur. Firmat anëtare nuk janë anëtar të një partneriteti ndërkombëtar ose partner juridik me njëri-tjetrin. Asnjë anëtar i vetëm nuk është përgjegjës për shërbimet ose veprimet e një firme tjetër anëtare. Edhe pse të gjitha firmat anëtare të plota marrin emrin RSM, nuk ka pronësi të përbashkët midis këtyre firmave ose pronësi të tyre nga RSM International Limited.

Brendi dhe marka tregtare RSM dhe të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale të përdorura nga anëtarët e rrjetit janë në pronësi të RSM International Association, një shoqatë e drejtuar nga neni 60 i Kodit Civil të Zvicrës, selia e të cilit është në Zug.

RSM Kosovo është anëtare e rrjetit RSM dhe operon si RSM. RSM është brend i përdorur nga anëtarët e rrjetit RSM. Çdo anëtar i rrjetit RSM është një firmë e pavarur e kontabilitetit dhe konsulencës që praktikon në vetvete.

RSM është rrjeti i gjashtë më i madh i firmave të pavarura të kontabilitetit dhe këshillimit, që përfshinë:

- firmat anëtare dhe korrespondente në 120 vende dhe janë në secilën prej 40 qendrave kryesore të biznesit në mbarë botën,
- staf të përgjithshëm prej plus 65,000 900 zyre që mbulojnë Amerikën, Evropën, Lindjen e mesme, Afrikën dhe Azinë e paqësorit.

Statistikat e RSM



65,000 njerëz në mbarë botën



900 zyra



120 shtete

Kërkesat e firmave anëtare

Firmat anëtare të RSM bien dakord të miratojnë dhe adaptojnë politikat dhe procedurat e mëposhtme si kërkesë për anëtarësim.

- Metodologjia RSM Orb
- Politikat dhe procedurat e sigurimit të cilësisë dhe përmbytjes së rrezikut të RSM;
- Politikat e Etikës dhe Pavarësisë të RSM-it;
- Politikat dhe udhëzimet e programit të inspektimit të firmës anëtare të RSM;
- Politikat për Trajnimin dhe Zhvillimin Profesional të Vazhdueshëm (CPD) për Shërbimet e Sigurimit të RSM
- Politikat dhe Udhëzimet Kundër Korrupsionit dhe Ryshfetit të RSM
- Politikat e Sigurisë së IT-së dhe Privatësisë së të Dhënave të RSM

Angazhimi i RSM International për cilësinë

Për të siguruar që çështjet e cilësisë të marrin kohën dhe vëmendjen e nevojshme për të nxitur ofrimin e shërbimeve profesionale me cilësi të lartë dhe uniforme, Bordi Ndërkombëtar i RSM ka themeluar Komitetin Global të Cilësisë ("GQC"). GQC, si një nënkomitet i Bordit Ndërkombëtar të RSM, funksionon si mbikëqyrës dhe si organ që jep rekomandime për Bordin Ndërkombëtar të RSM për shqyrtim dhe miratim përfundimtar. GQC nuk merr përsipër funksionet e menaxhimit, të cilat mbeten përgjegjësi e CEO-së Ndërkombëtar të RSM, zyrtarëve dhe anëtarëve të tjerë të menaxhmentit të lartë. Sipas mandatit të tij, Komiteti Global i Cilësisë (GQC), anëtarët e të cilit emërohen nga Bordi Ndërkombëtar i RSM, përbëhet nga pesë deri në nëntë partnerë ose ekuivalentë të kualifikuar dhe me përvojë nga firmat anëtare të RSM. Përbërja e GQC është projektuar për të siguruar përfaqësim nga të gjitha rajonet e RSM.

Kryetari i GQC zgjidhet nga Bordi Ndërkombëtar i RSM nga radhët e anëtarëve të GQC dhe shërben për një mandat trevjeçar, me mundësi rizgjedhjeje në fund të mandatit. Anëtarët aktualë të GQC vijnë nga firmat anëtare të RSM në Australi, Afrikën Lindore, Gjermani, Porto Riko, Singapor, Mbretërinë e Bashkuar dhe SHBA. Kryetari i GQC është nga firma anëtare e RSM në Mbretërinë e Bashkuar.


Çdo firmë anëtare individuale është e detyruar të krijojë një proces monitorimi të projektuar për t'i ofruar asaj siguri të arsyeshme që politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e kontrollit të cilësisë mbi shërbimet e sigurimit dhe shërbimet e tjera profesionale janë të përshtatshme, të mjaftueshme, funksionojnë në mënyrë efektive dhe janë në përputhje me pritshmëritë e RSM si dhe me të gjitha kërkesat përkatëse të përcaktuara nga bordet për vendosjen e standardeve të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC).

Politikat e Etikës dhe Pavarësisë

RSM mban politika të etikës dhe pavarësisë që të gjitha firmat anëtare janë të detyruara t'i adoptojnë. Këto politika ndihmojnë për të siguruar që firmat anëtare, partnerët dhe punonjësit profesionistë të përmbushin kërkesat për etikë dhe pavarësi të përcaktuara nga Kodi Ndërkombëtar i Etikës për Kontabilistët Profesionistë i Bordit Ndërkombëtar të Standardeve Etike për Kontabilistët (IESBA), përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë.

Çdo firmë anëtare ka një drejtues për etikën dhe pavarësinë – një partner (ose pozicion ekuivalent) që ka përgjegjësinë për të përmirësuar këto politika sipas nevojës. Kjo përfshin sigurimin që firma anëtare të reflektojë çdo kod etik lokal shtesë ose kërkesa rregullatore që vendosin standarde më të larta se ato të përfshira në politikat minimale të etikës dhe pavarësisë të RSM.

RSM ka një Komitet Global të Pavarësisë (GIC) të përbërë nga përfaqësues të firmave anëtare dhe anëtarë të GEO (Zyra Ekzekutive Globale). GIC ofron kontribut për GEO në çështjet e pavarësisë, përfshirë zhvillimin e politikave të etikës dhe pavarësisë.



Anëtarësimi në forumin e firmave

RSM është një anëtar i Forumit të Firmave, një shoqatë e rrjeteve ndërkombëtare të firmave të kontabilitetit që kryejnë auditime transnacionale. RSM është aktive dhe mbështet plotësisht objektivin e Forumit të Firmave, i cili është të promovojë standarde të qëndrueshme dhe me cilësi të lartë të raportimit financiar dhe praktikave të auditimit në të gjithë botën dhe të mbështesë konvergjencën e Standardeve Kombëtare të Auditimit me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Marion Hannon aktualisht përfaqëson RSM si një anëtar i Komitetit të Auditorëve Transnacional të Forumit të Firmave.

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Një mesazh nga Lideri Global, i Cilësisë dhe Riskut

Gjatë vitit të fundit kemi forcuar përkushtimin ndaj cilësisë me qëllim për të shërbyer më mirë një bazë klientësh të ndryshëm dhe dinamike. Të udhëhequr nga objektivat të vizionit tonë strategjik për vitin 2030, ne jemi përqendruar në sigurimin që përparësitë tona të mbeten të forta, të rëndësishme dhe të afta për të adresuar në mënyrë efektive peizazhin në ndryshim të rreziqeve me të cilat përballen Firmat Anëtare dhe klientët e tyre.

Pritshmëritë gjithnjë e më të larta rregullatore dhe një sfond gjeopolitik në ndryshim vazhdojnë të ndikojnë në kompleksitetin e mjedisit tonë global të biznesit. Prirja në rritje e investimeve të kapitalit privat në profesionin tonë paraqet sfida unike për veprimtarinë tonë. Si një sektor relativisht i ri për investimet e kapitalit privat, kjo prirje shton një faktor tjetër kompleksiteti në përputhjen rregullatore dhe funksionimin operativ. Kjo nënvizon nevojën për të mbetur vigjilentë dhe proaktivë, duke u përpjekur të përshtatemi shpejt me dinamikën e tregut që është në ndryshim të vazhdueshëm.

Pavarësisht këtyre kompleksiteteve, angazhimi ynë për të ruajtur standardet më të larta të përputhshmërisë dhe përgjegjësisë etike mbetet i palëkundur. Përmes zbatimit të nismave si Vlerësimi Global i Pavarësisë (GIA), i cili do të lehtësojë autorizimin e shërbimeve në të gjithë Rrjetin, Ne jemi të përkushtuar të forcojmë metodat dhe zbatimin tonë për përputhshmëri në pavarësi dhe përgjegjësi etike.

GIA shërben si një mjet thelbësor për racionalizimin e proceseve, duke mundësuar ndjekje të qëndrueshme të standardeve globale dhe përmirësuar aftësinë tonë për të ofruar shërbime me integritet dhe saktësi. Duke adresuar tendencat në ndryshim të vazhdueshëm dhe kërkesat rregullatore, si dhe duke nxitur mbikëqyrje të besueshme, GIA ndihmon në forcimin e besimit të klientëve tanë dhe palëve të tjera të interesuara më gjerë.

Përveç nxitjes së një angazhimi të shtuar ndaj përputhshmërisë dhe përgjegjësisë etike, mjedisi aktual global ka çuar në thellimin e përqendrimit tonë në menaxhimin e rrezikut.

Si një organizatë globale që u shërben klientëve që variojnë nga individët deri te korporatat

shumëkombëshe, në disa juridiksione rregullatore, menaxhimi i rrezikut në mënyrë të koordinuar dhe të lidhur është kyç. Ne jemi të përqendruar në zhvillimin e kuadrit tonë të menaxhimit të rrezikut për t'u përshtatur me ndryshimet dhe rritjen tonë, si dhe me ndryshimet në tregjet ku operojmë.

Qasja jonë ndaj menaxhimit të rrezikut synon të balancojë rreziqet tradicionale me të cilat përballlet një biznes si i yni – si rregulloret, pavarësia dhe cilësia – me rreziqet në zhvillim që prekin organizatën tonë, si siguria kibernetike. Edhe pse inovacioni teknologjik është thelbësor, investimi në njerëzit tanë dhe proceset e orientuara drejt njeriut është po aq kritik për të nxitur qëndrueshmëri dhe fleksibilitet në të gjithë rrjetin.

Investimet tona të vazhdueshme në trajnim synojnë të fuqizojnë Firmat Anëtare. Si pjesë e kësaj, ne kemi përditësuar dhe përmirësuar programet tona të trajnimit për RSM Orb dhe për Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS), për të siguruar që Stafi ynë të jetë i përditësuar me kërkesat teknike në këto fusha.

Ne jemi po aq të përkushtuar për të adresuar nevojat dhe kërkesat në zhvillim për raportimin e qëndrueshmërisë. Përpjekjet tona janë përputhur me standardet kryesore globale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në IFRS S1 dhe S2, si dhe Direktivën për Raportimin e Qëndrueshmërisë së Korporatave (CSRD), duke treguar përkushtimin tonë për të mbështetur klientët me zgjidhjet që u nevojiten për të përmbushur kërkesat rregullatore të qëndrueshmërisë. Gjithashtu, kemi përshtatur qasjen dhe zgjidhjet tona për t'iu përgjigjur paketës Omnibus të Komisionit Evropian.

Ndërsa ecim përpara, mbetemi të palëkundur në angazhimin tonë ndaj integritetit dhe cilësisë. Ne përpiqemi të përballojmë sfidat e së tashmes për të siguruar që të jemi të përgatitur për të lundruar nëpër kompleksitetet e së ardhmes.

"Mbetemi të përkushtuar ndaj ndjekjes së pandërprerë të standardeve më të larta të cilësisë, përmes vizionit tonë të vazhdueshëm për të ndërtuar besim në një botë të karakterizuar nga ndryshimi i vazhdueshëm"

Marion Hannon

Udhëheqëse Globale për Cilësinë & Riskun, RSM International

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

RSM Kosova ka hartuar, zbatuar dhe operuar një sistem të menaxhimit të cilësisë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Menaxhimin e Cilësisë (ISQM) 1, të lëshuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Auditimit dhe Sigurimit të Cilësisë (IAASB). Ky sistem i menaxhimit të cilësisë funksionon në mënyrë të vazhdueshme dhe ciklike, duke u përshtatur me ndryshimet në natyrën dhe rrethanat e firmes dhe angazhimeve të saj.

Rregullatorët dhe përcaktuesit e standardeve në Kosovë dhe në nivel global gjithashtu janë të përqendruar te efektiviteti dhe përmirësimet e vazhdueshme në sistemet e menaxhimit të cilësisë (SQM) të firmave. RSM Kosova respekton ISQM 1, i cili kërkon vlerësimin vjetor të SQMsë. ISQM 1 prezantoi një qasje të bazuar në rrezik për SQM që kërkon që firmat t'i përgjigjen objektivave të cilësisë dhe rreziqeve ndaj aftësisë sonë për të ekzekutuar auditime me cilësi të lartë.

Një sistem menaxhimi i cilësisë përfshin tetë komponentë të mëposhtëm:

- Procesi i Vlerësimit të Rrezikut të Firmës Anëtare;
- Qeverisja dhe Lidërimi;
- Kërkesat etike përkatëse;
- Pranimit dhe vazhdimi i marrëdhënieve me klientët dhe angazhimeve specifike;
- Performanca e angazhimit;
- Burimet;
- Informacioni dhe komunikimi; dhe
- Procesi i monitorimit dhe përmirësimit.

Zbatimi efektiv i ISQM 1 ka qenë dhe mbetet një element kyç i strategjisë së cilësisë së auditimit të RSM.


Si pjesë e zbatimit të ISQM 1, objektivat e cilësisë, rreziqet e cilësisë dhe përgjigjet u zyrtarizuan dhe u mbledhën së bashku në format e ofruara nga zyra ekzekutive e RSM. RSM Kosova ka përdorur gjitha resurset e ofruara nga zyret ekzekutive sic janë:

- Një version i përditësuar i mjetit proforma për dokumentimin e objektivave, rreziqeve të cilësisë dhe përgjigjeve përkatëse brenda sistemit të menaxhimit të cilësisë.
- Një mjet proforma për dokumentimin e vlerësimit vjetor në një moment të caktuar në kohë, si dhe për vlerësimin e mangësive.

- Rezultatet e inspektimeve të rrjetit nga cikli i vitit të kaluar, për t'u marrë në konsideratë në raport me ndikimin e tyre mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë.
- Katër kurse gjithëpërfshirëse online mbi zbatimin praktik të ISQM 1, të cilat janë të disponueshme për të gjitha Firmat Anëtare në RSM Campus, platforma jonë globale për menaxhimin e të nxënësve. Këto kurse mbulojnë:
 - Hartimi dhe zbatimi i aktiviteteve të monitorimit.
 - Vlerësimi i gjetjeve nga aktivitetet e monitorimit, në përputhje me kërkesat e ISQM 1 dhe politikat e RSM, për të identifikuar mangësitë në sistemin e menaxhimit të cilësisë.

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Më poshtë paraqitet një përfaqësim grafik i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë të RSM Kosovës.



Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Toni në krye

Krijimi, kultivimi dhe ruajtja e një kulture respekti dhe hapjeje është pjesë e ADN-së së Firmës, dhe ne qëndrojmë besnikë ndaj vlerave tona në vendimet, angazhimet dhe komunikimet tona, si brenda ashtu edhe jashtë organizatës.

Konsistenca e tonit vendos themelin për ofrimin e auditimeve me cilësi të lartë. Udhëheqësia jonë e kupton nevojën për vlerën shoqërore të një auditimi, përfitimet për palët e interesuara të shumta dhe domosdoshmërinë absolute për cilësi të lartë.

Njerëzit tanë janë vetë biznesi ynë dhe në mjedisin pas pandemisë kemi dëshmuar forcën tonë në mbështetjen e stafit dhe partnerëve tanë.

Ne jemi përshtatur me mënyra të reja pune dhe kemi marrë kohë për të dëgjuar njerëzit tanë, si në mënyrë të strukturuar ashtu edhe të pastrukturuar. Motoja jonë "njerëzit në radhë të parë" na ka mundësuar jo vetëm të mbijetojmë, por në fakt të lulëzojmë.

Udhëheqja dhe qeverisja

Ne jemi të përkushtuar ndaj një strukture që mbështet dhe mundëson ofrimin dhe monitorimin e cilësisë së auditimit.

E mbajmë strukturën tonë të udhëheqjes dhe qeverisjes nën shqyrtim të vazhdueshëm, në mënyrë që të bëhen përmirësime ndërsa biznesi ynë zhvillohet, qoftë për shkak të mjedisit rregullator, rritjes apo faktorëve të tjerë.

Politikat dhe Procedurat e etikës dhe pavarësisë

RSM Kosovo ka krijuar sisteme dhe procedura të përshtatshme për të ndihmuar në ruajtjen e objektivitetit të stafit dhe për të shmangur konfliktin e interes në përputhje me politikat e etikës dhe pavarësisë të aplikuara nga RSM International. Këto politika ofrojnë siguri të arsyeshme që firmat anëtare, partnerët dhe punonjësit profesionistë janë në përputhje me pavarësinë dhe kërkesat etike të :


- bordi i standardeve ndërkombëtare të etikës për profesionistët kontabël ("Kodi IESBA")
- politikat, udhëzimet dhe kërkesat ndërkombëtare të RSM International,
- kërkesat tjera ligjore lokale.

Trajnimi i etikës është pjesë e procedurës së hyrjes për anëtarët e rinj të stafit.

Nga partnerët dhe punonjësit profesionalë kërkohet që çdo vit plotësimi i një pyetësori të pajtueshmërisë së pavarësisë që konfirmon se ai ose ajo:

- ka lexuar politikat e etikës dhe pavarësisë së RSM-së,
- kupton zbatueshmërinë e tyre në aktivitetet e tij / saj,
- është, dhe ka qenë për vitin e kaluar, në përputhje me ato politikat.

Çdo mos përputhje me këto politika duhet të raportohet dhe veprime korigjuse ndërmiren nga bordi i partnerëve.



Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Rotacioni i Partnerëve Kryesorë të Auditimit dhe Stafit

Politikat e Etikës dhe Pavarësisë të RSM përmbajnë kërkesa për rrotacionin e detyrueshëm të partnerit të angazhimit në auditimet e subjekteve me interes publik, duke kërkuar që rotacioni të ndodhë jo më vonë se pas shtatë vitesh nga data e emërimit të tyre.

Për më tepër, këto politika ndalojnë rikthimin e tyre në ekipin e auditimit të subjektit të audituar para se të kenë kaluar pesë vite të plota pas përfundimit të angazhimit të mëparshëm.

Politikat e Etikës dhe Pavarësisë të RSM kërkojnë rrotacionin e detyrueshëm të rishikuesit të cilësisë së angazhimit jo më vonë se shtatë vjet nga data e emërimit të tij.

Gjithashtu, këto politika ndalojnë rikthimin e tij në auditimin ligjor të subjektit të audituar përpara se të kenë kaluar tre vite të plota pas përfundimit të angazhimit.

Pavarësia, marrëdhëniet dhe monitorimi i konfliktit të interes

RSM mban pavarësinë, monitorimin e marrëdhënieve dhe konfliktit të interes duke përdorur aplikacionin RSM Intrust/GIA. Firmave anëtare u kërkohet të përdorin RSM Intrust për të renditur të shërbimeve audituse dhe jo audituse për kategoritë e mëposhtme:

- subjektet e interesit publik, përfshirë entitetet e listuara, subjektet private me pronësi ose bashkëpunëtorë të vendosur në një juridiksion tjetër ose një vend, përfshirë perfituesin e fundit, kompaninë mëmë të ndërmjetme, motra ndërmarrje, filiale ose bashkëpunëtorë,
- grupet ose fondet e kapitalit privat.

Për më tepër, të gjithë klientët që janë filialë ose bashkëpunëtorë të grupeve plotësimi i kriterëve të mësipërme kërkohet të përfshihen në in trust. Partnerët dhe punonjës profesionalë të firmës kërkohet që të konsultohen me in trust dhe të marrin masa të tjera paraprake që konsiderohen të nevojshme në rrethana për të siguruar pajtueshmërinë me etikën dhe politikat e pavarësisë së RSM.

RSM gjithashtu mban regjistrat e mëposhtëm:

- Pozitat e jashtme të mbajtura nga Partnerët ose Punonjësit, p.sh. drejtor; zyrtar; sekretar kompanie; dhe kujdestar;
- Të gjitha Interesat Financiare të Firmës dhe Marrëveshjet e Tjera Financiare;
- Të gjitha Marrëdhëniet e Afërta të Biznesit; dhe
- Të gjitha proceset gjyqësore aktuale dhe të pritshme.

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Procesi i zgjedhjes së konflikteve

Kur partneri i firmës anëtare ose punonjësi profesional identifikon një rrezik të mundshëm të pavarësisë ose konflikt interesi në lidhje me një klient ose klient të ardhshëm të një anëtari tjetër, firma përmes kërkimeve në RSM in Trust dhe kontrolleve të tjera të konfliktit të interesave, partneri ndërkombëtar i kontaktit (ICP) i firmës anëtare duhet të informohet.

Nëse firmat anëtare nuk janë në gjendje të bien dakord për masat mbrojtëse të përshtatshme, zyra ekezekutive globale (GEO) dhe Kryetari i Bordit kërkohet të marrin në konsideratë dëmtimin e mundshëm të pavarësisë ose konflikti i interesit. Firmat anëtare duhet të japin GEO informacionin e nevojshëm në lidhje me faktet dhe rrethanat përkatëse, cilat do të përdoren për të vlerësuar dëmtimin e mundshëm të pavarësisë ose konflikti i interesit. GEO dhe Kryetari i Bordit, pasi të keni shqyrtuar kërkesën dhe informacionin e dhënë, bëjnë një rekomandim për zgjidhjen e dëmtimit të mundshëm të pavarësisë ose konfliktit të interesit.

Pranimi dhe vazhdimi i relacioneve me klient

Sigurimi i shërbimeve të auditimit me cilësi të lartë kërkon që RSM firmat anëtare pranojnë vetëm klientë që ndajnë thelbin e RSM në vlerat dhe besimet. RSM Kosova hynë vetëm në marrëdhëniet me klientët që përshtaten me kriteret kryesore të pranimit të RSM dhe të cilët janë të përgatitur të paguajnë një tarifë të drejtë për punën me vlera të larta.

Gjatë procesit të pranimit të klientëve partneri i angazhimit vlerëson nivelin e rrezikut të angazhimit dhe përcakton në qoftë se kërkesa speciale për personel, mbikëqyrje dhe rishikim duhet të angazhohen. Një partner i dytë kërkohet të pajtohet me pranimin e klientit, nëse plotëson profile të caktuara të rrezikut. Keto procedurat dokumentohen në formularë të standardizuar "Pranimi dhe Vazhdueshmëria" e angazhimeve të auditimit. Këta formularë janë të detyrueshëm për të gjitha angazhimet.

Metodologjia e Auditimit – RSM Orb

RSM Orb, zgjidhja e auditimit të bazuar në rrezik e RSM, siguron që Firmat Anëtare të kryejnë auditime me cilësi të lartë. Ajo përbëhet nga katër elementë kryesorë:

- Metodologjia Ekskluzive Globale e Auditimit
- Manuali Global i Auditimit
- Modele të personalizuar për dokumentimin digjital të auditimit nga RSM
- Udhëzime për zbatimin praktik

Në përputhje me përqendrimin e RSM për të arritur metoda dhe procese të përbashkëta në të gjithë Rrjetin, përdorimi i RSM Orb është i detyrueshëm për të gjitha auditimet nga të gjitha Firmat Anëtare. Për të mbështetur zbatimin në nivel lokal, RSM Orb është në dispozicion në disa gjuhë, përfshirë kinezisht, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, rusisht dhe spanjisht.

RSM Orb u mundëson auditorëve të përqendrohen te rreziqet dhe të projektojnë procedura të përshtatura sipas çdo rrethane dhe mjedisi të veçantë. Kjo siguron që auditimet e RSM të jenë të qëndrueshme, novatore, të mbështetura në analiza kritike dhe të besueshme.

Si pjesë e angazhimit tonë për cilësi, RSM ka zhvilluar një program trajnimi katërvjeçar për auditimin, i cili mbulon aspekte të ndryshme të metodologjisë sonë të auditimit.

Kurrikula e trajnimit për RSM Orb përfshin 75 module, të disponueshme për të gjitha Firmat Anëtare në RSM Campus në gjuhët anglisht dhe spanjisht. Për më tepër, Firmat Anëtare mund të zhvillojnë trajnime shtesë për të plotësuar nevojat lokale dhe për të zgjeruar njohuritë përtej kurrikulës bazë.



Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Metodologjia e Auditimit – RSM Orb vazhdim

Gjatë vitit 2024, u pilotua një chatbot i brendshëm me mbështetje nga AI, që përfaqëson një tjetër hap të rëndësishëm në konsolidimin e një kulture cilësie. Chatbot-i është krijuar për të ndihmuar auditorët të kenë akses të menjëhershëm dhe të kuptojnë më lehtë Manualin Global të Auditimit, duke rritur më tej koherencën dhe besueshmërinë e shërbimeve tona të auditimit në mbarë botën.

RSM Orb përfshin gjithashtu kërkesa për:

- Rishikime të cilësisë së angazhimit
- Konsultime të detyrueshme me Udhëheqësin e Auditimit, Udhëheqësin e Etikës dhe Pavarësisë (ose përfaqësuesit e tyre), ose persona të tjerë të kualifikuar, sipas rastit.

RSM Orb është në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

- Standardet Ndërkombëtare për Menaxhimin e Cilësisë (ISQM), të publikuara nga IAASB
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA), të publikuara nga IAASB
- Deklaratat e Praktikës së Auditimit Ndërkombëtar (IAPS), të IAASB
- Politikat e RSM për Sigurimin e Cilësisë dhe Kufizimin e Rreziqeve

Firmat Anëtare mund të përshtatin RSM Orb për të përfshirë kërkesa shtesë që rrjedhin nga legjislacioni dhe rregulloret lokale në juridiksionin e tyre.

RSM Orb

- Metodologjia optimale e auditimit të bazuar në rrezik e RSM.
- E dizajnuar me fokus te segmenti i tregut të mesëm.
- Përshtatet me kompleksitetin e klientit.
- Përqendrohet te rreziqet e klientit dhe është e aftë të adaptohet ndaj rrethanave të ndryshme.
- Mundëson ofrimin e auditimeve cilësore dhe të qëndrueshme.

RSM Orb u jep mundësi Firmave Anëtare të zhvillojnë një kuptim më të thellë të klientëve të tyre, duke ofruar njohuri kritike për nevojat e tanishme dhe të ardhshme.

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Burimet Njerëzore

Firma ka zhvilluar dhe zbatuar politika dhe procedura të strukturuar që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore, me qëllim sigurimin e cilësisë së lartë në ofrimin e shërbimeve profesionale. Këto politika synojnë të garantojnë që personeli i angazhuar të jetë i kualifikuar, kompetent dhe i përkushtuar ndaj standardeve etike dhe profesionale.

Objektivat kryesore:

- **Rekrutimi i stafit të kualifikuar:** Sigurimi që individët e punësuar posedojnë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të përmbushur detyrat profesionale në mënyrë efektive.
- **Zhvillimi profesional i vazhdueshëm:** Mbatja dhe përmirësimi i kompetencës përmes trajnimeve të rregullta, edukimit profesional dhe vlerësimit të njohurive.
- **Përputhshmëria me standardet e cilësisë dhe etikës:** Sigurimi që të gjitha proceset e burimeve njerëzore janë në përputhje me kërkesat e standardeve, ligjeve dhe standardet etike përkatëse.

Procedurat e zbatuara përfshijnë:

- **Planifikimi i nevojave për punësim:** Identifikimi i pozicioneve të nevojshme dhe përcaktimi i kriterëve për rekrutim.
- **Metodat e rekrutimit dhe vlerësimi i kandidatëve:** Përdorimi i metodave të strukturuar për përzgjedhjen e kandidatëve më të përshtatshëm.
- **Emërimi i personave përgjegjës për procesin e punësimit:** Caktimi i stafit të autorizuar për menaxhimin e rekrutimit.
- **Verifikimi i efektivitetit të punësimit:** Monitorimi i pajtueshmërisë me procedurat e vendosura dhe vlerësimi i performancës së stafit të ri.

- **Përcaktimi i kualifikimeve dhe përgjegjësi sipas niveleve profesionale:** Hartimi i profileve të qarta për çdo nivel profesional, duke përfshirë detyrat, përgjegjësitë dhe kërkesat për ekspertizë.



Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Monitorimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë

Qëllimi i monitorimit është të sigurojë që Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë (SMC) funksionon në mënyrë efektive dhe se objektivat e tij po arrihen në praktikë. Monitorimi është një komponent thelbësor i ISQM 1 dhe ndihmon në identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e mangësive në sistemin e cilësisë.

Firma duhet të krijojë një proces të monitorimit dhe remedimit me qëllim që:

- Të sigurojë informacion të rëndësishëm, të besueshëm dhe në kohë lidhur me projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë;
- Të ndërmarrë veprime të përshtatshme për të adresuar mangësitë e identifikuara, në mënyrë që ato të korrigjohen në kohë.

Firma duhet të projektojë dhe të kryejë aktivitete monitorimi që ofrojnë bazë për identifikimin e mangësive.

Përveç mundësisë të vlerësimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë, procesi i monitorimit dhe remedimit lehtëson përmirësimin proaktiv dhe të vazhdueshëm të cilësisë së angazhimeve dhe të vetë sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Engagement Quality Review (EQR)

Rishikimi i cilësisë së performancës së angazhimeve është një proces veçanërisht i rëndësishëm në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Firma ka krijuar dhe zbatuar procedura të përshtatshme për rishikimin e cilësisë në nivel angazhimi, të cilat ofrojnë një vlerësim objektiv të vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga ekipi i auditimit gjatë zbatimit të angazhimit, si dhe të përfundimeve të arritura gjatë formulimit të raportit të auditimit.

Firma përdor një metodologji dhe kritere të përshtatura nga RSM Global për të klasifikuar angazhimet sipas nivelit të rrezikut që lidhet si me ekipin e auditimit, ashtu edhe me vetë angazhimin.

Duke analizuar lidhjen ndërmjet këtyre dy llojeve të rrezikut përmes një modeli të përshtatshëm, firma përcakton se për cilat angazhime është e nevojshme të caktohet një rishikues i pavarur i cilësisë. Një rishikim i pavarur i cilësisë është i detyrueshëm për angazhimet e auditimit të klientëve të listuar, si dhe për kompanitë me interes publik.

Rezultatet e monitorimit të cilësisë së auditimit

Rishikimet ndodhin çdo vit si pjesë e Programit tonë të Kontrollit të Firmave Anëtare. Çdo tre vite, inspektimi realizohet nga RSM Global. Rishikimi arrin një mbulim të arsyeshëm të dosjeve, rishikimet e dosjeve të Sigurimit të Cilësisë ("QA") përfshijnë një përzierje të llojeve dhe madhësive klientit, përfshirë auditimet e ndryshme të specializuara si institucione financiare. Koordinator i Inspektimit i paraqet çdo vit Bordit gjetjet e inspektimit, i cili përcakton çdo shqetësim aktual dhe marrjen e përgjigjeve dhe veprimeve të menjëhershme sipas nevojës. Një raport që përfshin këto gjetje dhe planin e veprimit i paraqitet RSM Global.

Në përputhje me politikën RSM Global Firma është inspektuar nga RSM Global në tetor 2023. Inspektimi përfshin një rishikim të një mostre të dosjeve të auditimit dhe shërbimeve tjera si dhe Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë (SOQM) në nivel firme. Raporti i inspektimit final u dërgua nga RSM Global në mars 2024 dhe nuk kishte gjetje signifikante. Bordi është i përfshirë ngushtë me të gjitha vizitat rregullore dhe shqyrton në mënyrë të detajuar të gjitha gjetjet dhe rekomandimet. Trajnimet dhe proceset tona janë nën rishikim të vazhdueshëm për të siguruar që auditimet tona janë me cilësi më të lartë.

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Janë ndërmarrë veprime për të adresuar fushat për përmirësimin e sugjeruar të identifikuar në raportet e inspektimit. Ne vazhdojmë t'i përgjigjemi shqyrtimeve të fundit dhe praktikës më të mirë aktuale. Progresi në zbatimin e këtyre veprimeve është, dhe do të vazhdojë të monitorohet nga Bordi.

Vlerësimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë

Trupi drejtues I RSM Kosovo I cili ka përgjesin kryesor lidhur me vlersimin e fektivitet te SQM-se ka kryer vlerësimin e saj vjetor dhe ka konkluduar, në emër të firmës, se sistemi i menaxhimit të cilësisë:

a) I siguron firmës një siguri të arsyeshme që objektivat e sistemit të menaxhimit të cilësisë po arrihen.

Rezultatet e monitorimit të jashtëm

Këshilli Kosovar për Raportim Financiar dhe Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK) bëjnë monitorimin e cilësisë së auditimit të firmave dhe antarëve të shoqatës. Gjatë vitit 2024 , Bordi I Mbikqytjes Publike (BMP) organ ekzekutiv i Këshilli Kosovar për Raportim Financiar ka rishikuar cilësinë e auditimit të antarëve të saj dhe raporti i kontrollit te cilësisë nga BMP ka qenë pozitiv.



Edukimi i vazhdueshëm profesional, rekrutimi dhe zhvillimi personal

Trajnimi dhe mbështetja

Investimi në trajnimin dhe zhvillimin e stafit tonë është me rëndësi të veçantë.

RSM Campus ofron një platformë edukimi që përfshin një gamë të gjerë kursesh për nevoja të ndryshme, të cilat janë të disponueshme për të gjithë stafin e RSM. Kjo siguron që të gjithë në rrjet të kenë qasje në burimet më të fundit të trajnimit dhe mundësitë për zhvillim profesional.

RSM Campus është gjithashtu vendi ku anëtarët e ekipit regjistrojnë trajnimet e tyre për qëllime të Zhvillimit Profesional të Vazhdueshëm (CPD).

Përveç kurseve në fusha kyçe si auditimi, këshillimi dhe etika, RSM Campus përfshin edhe trajnime që adresojnë fusha për përmirësim të identifikuar nga komentet e rregullatorëve, si dhe sfida të zakonshme të industrisë dhe ndikimin e përditësimeve në ISA, IFRS dhe FRS.

Ekipi ynë për trajnime teknike dhe zhvillim ofron një program bazë për trajnime në auditim dhe raportim financiar për të gjithë stafin e auditimit, për të siguruar që ata janë të përditësuar me rregulloret dhe standardet aktuale. Trajnime shtesë ofrohen sipas roleve dhe fushave të specializimit të partnerëve dhe stafit.

Nëse identifikohen fusha që kërkojnë zhvillim në procesin e auditimit, ekipi harton një kurs të dedikuar për t'i adresuar ato sa më shpejt.

Kjo ka ndodhur, për shembull, me rritjen e rëndësisë së tregut të kriptomonedhave, ku janë zhvilluar trajnime për kontabilitetin dhe auditimin e aseteve krypto, si dhe trajnime shtesë për auditimet në sektorin e sigurimeve.

Materialet etike janë lehtësisht të aksesueshme dhe trajnimi u ofrohet stafit në të gjitha nivelet, duke mbuluar detyrimet etike të jashtme ndaj të cilave firma është e detyruar.

Trajnimi i këtij viti në këtë fushë është fokusuar kryesisht në ndryshimet në Kodin e Etikës të IESBA. Partnerët dhe stafi i auditimit janë informuar për nevojën për të konsultuar ekipin e etikës për çdo çështje, veçanërisht ato që lidhen me interpretimin, për të cilat nuk janë të sigurt.

Trajnim adekuat është ofruar edhe për standardin e ri të cilësisë ISQM 2, ku stafi është njohur me kërkesat e standardit në lidhje me emërimin, përshtatshmërinë dhe përgjegjësitë e rishikuesit të cilësisë së angazhimit (Engagement Quality Reviewer).

Firma gjithashtu mbulon kostot dhe ofron leje studimi për kurset e trajnimit, përfshirë edhe për anëtarët e stafit që ndjekin kualifikimet profesionale në kontabilitet.

Edukimi i vazhdueshëm profesional

Si pjesë e angazhimit tonë për cilësi, RSM ka zhvilluar një program trajnimi katërvjeçar për auditimin me module që mbulojnë aspekte të ndryshme të metodologjisë sonë të auditimit. Kurrikula e kursit RSM Orb përbëhet nga 75 module dhe është e disponueshme për të gjitha Firmat Anëtare në RSM Campus.

Partnerët përgjegjës dhe stafi i RSM Kosovo sh.p.k perveq qasjes në RSM Campus janë anëtar në shoqat profesionale në Kosovë si dhe anëtar të "Association of Chartered Certified Accountants (ACCA)".

Gjatë këtij viti, Shoqata e profesionale ka zhvilluar disa sesione të edukimit të vazhdueshëm profesional mbi SNRF dhe ripërditësimet e auditimit. Gjithashtu dhe stafit u sigurohet trajnim i mëtutjeshëm sipas roleve specifike dhe fushave të specializimit.

Si pjesë e programit të EVP-së, Menaxherët dhe stafi gjithashtu ndjekin kurse në fusha për të përmirësuar cilësinë e auditimit, pasi ne e pranojmë që nivele të larta të aftësive në këto fusha ndihmojnë për të siguruar që auditimet të funksionojnë në mënyrë të qetë dhe efektive dhe njohuritë teknike përkatëse mund të zbatohen në fazat e duhura të auditimit.

Edukimi i vazhdueshëm profesional, rekrutimi dhe zhvillimi personal

Rekrutimi

Përmes politikave dhe proceseve tona të rekrutimit dhe trajnimit, ne sigurohemi që të tërheqim individë të talentuar dhe t'u sigurojmë atyre zhvillim dhe aftësi që u duhen për të përmbushur një karrierë të gjatë dhe të përkushtuar me RSM.

Praktika jonë e rekrutimit siguron që ne të arrijmë në sa më shumë individë të talentuar, si dhe përmes punësimit direkt. Metodologjitë tona të përzgjedhjes përqendrohen në vlerësimin e gamës së plotë të aftësive dhe cilësive që besojmë se janë thelbësore për të pasur sukses si auditor në RSM.

Ne jemi gjithmonë në kërkim të anëtarëve të talentuar, të kualifikuar dhe me përvojë të stafit.

Vlerësimi

Ne kemi investuar kohë dhe energji të konsiderueshme për të siguruar që punonjësit të dinë se çfarë pritët prej tyre në çdo fazë të karrierës së tyre, në mënyrë që ata të dinë se si të përparojnë. Të kesh kompetenca të qarta për stafin në çdo nivel gjithashtu do të thotë që klientët tanë mund të sigurohen për të njëjtin nivel shërbimi, pavarësisht nga vendndodhja. Çdo punonjës ka reagime dhe vlerësime të rregullta. Firma kryen një vlerësim të fundvitit për të rishikuar progresin e objektivave të përcaktuara në vlerësimin e fundvitit. Cilësia e auditimit është në themel të secilit vlerësim. EVP-të e ndjekura dhe progresi ekzaminues i individit, sipas rastit, gjithashtu diskutohen gjatë vlerësimit.

Promovimet rekomandohen nga Kryesuesi i Departamentit. Bordi vlerëson raportin e dhënë nga drejtuesi i departamentit përkatës për individët në fjalë.

Zhvillimi personal

Zhvillimi i njerëzve tonë është diçka për të cilën RSM është e apasionuar. Ne ofrojmë një gamë të gjerë të kurseve të zhvillimit personal, të cilat janë krijuar për të mbështetur individët ndërsa përparojnë gjatë karrierës së tyre.

Ne ofrojmë një shumëllojshmëri kursesh që lejojnë punonjësit të përshtatin zhvillimin e tyre bazuar në nevojat e tyre personale si në rolin e tyre aktual ashtu edhe pasi ato përparojnë përmes roleve të ndryshme gjatë karrierës së tyre.

Kompania është e përkushtuar të zhvillojë një kulturë mentorimi dhe të mbështesë mentorët dhe anëtarët tanë të rinj për ta bërë këtë marrëdhënie të funksionoj. Ne besojmë se të gjithë meritojnë të kenë dikë në biznes përveç menaxherit të tyre të linjës që udhëzon dhe mbështet udhëtimin e tyre në karrierë. Trajnimi është thelbësor për zbulimin e potencialit në stafin tonë për të maksimizuar performancën e tyre dhe për të kontribuar në suksesin e ardhshëm të Kompanisë. Për të arritur këtë, ne marrim përsipër trajnime në punë për të ndërtuar aftësi dhe shkathtësi në rolet ekzistuese, zhvillojmë trajnime për të mbështetur përparimin e ardhshëm dhe trajnimin e sjelljes për të arritur një ndryshim afatëgjatë domethënës përmes rritjes së vetëdijësisë.

Ekzistojnë mundësi shkëmbimi në dispozicion të punonjësve në mënyrë që ata të arrijnë një thellësi më të madhe përvoja dhe kuptimi të industrisë dhe biznesit tonë, të cilat mund të nxirren pas kthimit të tyre.



Kompensimi i Partnerëve

Është besimi ynë i palëkundur se cilësia e auditimit përmirësohet më së miri duke implikuar tek Partnerë etikën se cilësia e auditimit është në thelb të gjithçkaje që ne bëjmë.

Performanca e një drejtori vlerësohet në bazë të rolit individual, kontributit dhe përputhshmërisë me standardet profesionale.

Partnerët dhe drejtorët e Kompanisë shpërblehen me paga dhe pjesë të bonusit, kjo e fundit përcaktohet duke iu referuar vlerësimit i cili është i lidhur me kriteret e cilësisë së auditimit si në rishikimin e performancës së kaluar, ashtu edhe në objektivat për vitin e ardhshëm.



Auditimi i subjekteve me interes publik

RSM Kosovo gjatë vitit financiar 2024 ka kryer auditimet e mëposhtme të pasqyrave financiare të subjekteve me interes publik.

Nr.	Emri i klientit	Industria	Për vitin e përfunduar
1	Hib Petrol Sh.p.k	Tregti dhe shërbime	31 dhjetor 2023
2	Buçaj Sh.p.k.	Tregti dhe shërbime	31 dhjetor 2023
3	Birra Peja Sh.a	Prodhim	31 dhjetor 2023
4	HIB Holding Sh.p.k	Holding	31 dhjetor 2023
5	Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S Dega në Kosovë	Banka	31 dhjetor 2023
6	Unioni Financiar Prishtinë Sh.p.k.	IFJB	31 dhjetor 2023
7	Turkiye IS Bankasi A.S. Dega në Kosovë	Banka	31 dhjetor 2023
8	KGMAMF	Microfinanca	31 dhjetor 2023
9	Banka Credins Kosovë SH.A	Banka	31 dhjetor 2023
10	Fondi I Kursimeve Pensionale të Kosovës	Fonde pensionale	31 dhjetor 2023
11	Rroni Fer Sh.p.k	Prodhim	31 dhjetor 2023
12	Banka Ekonomike Sh.a	Banka	31 dhjetor 2023
13	Hib Coporation Sh.p.k	Tregti dhe shërbime	31 dhjetor 2023

*Shpalosja në përputhje me nenin 10, paragrafi 5.6 i ligjit nr. 06/L –032 për Kontabilitet, Raportimin Financiar dhe.

Shënimet Financiare

Në tabelen më poshtë janë të prezantuara të hyrat e Kompanisë të realizuara gjatë vitit 2024.:

	2024 (EUR)
Shërbimet e auditimi- (SiP)	176,233
Shërbimet e auditimi- (Jo SiP) , shërbime tjera të sigurisë dhe shërbime të ndërlidhura	166,831
Shërbimet e kontabilitetit, taksave dhe konsulencës	196,570
	539,634

SHTOJCA

Deklaratë e Bordit të Partnerëve
për efektivitetin e funksionimit të
sistemit të kontrollit të cilësisë

Deklarata e pavarësisë

Deklarata mbi edukimin e
vazhdueshëm profesional

Deklaratë e Bordit të Partnerëve për efektivitetin e funksionimit të sistemit të kontrollit të cilësisë

Gjatë vitit 2024, RSM Kosovo sh.p.k. ka vazhduar të investojë në forcimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të saj të brendshëm të menaxhimit të cilësisë, në përputhje të plotë me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar për Menaxhimin e Cilësisë 1 (ISQM 1). Gjatë vitit, kemi zbatuar një kuadër të qëndrueshëm të menaxhimit të cilësisë, i cili mbështet ofrimin e shërbimeve të besueshme, me integritet dhe me cilësi të lartë.

Sistemi ynë mbulon të gjithë komponentët kyç të ISQM 1, përfshirë: qeverisjen, lidhshërinë, etikën dhe pavarësinë, pranimin dhe vazhdimësinë e klientëve, performancën e angazhimeve, burimet (njerëzore, teknologjike dhe metodologjike) si dhe monitorimin e përmirësimit.

Për të siguruar efektivitetin e vazhdueshëm të sistemit, gjatë vitit 2024 kemi kryer rishikime të brendshme mbi angazhimet e përfunduara, kemi analizuar shkaqet rrënjësore të çdo mangësie të identifikuar dhe kemi ndërmarrë masa përmirësuese aty ku ka qenë e nevojshme. Këto masa janë shoqëruar me trajnime të rregullta për stafin, përditësime të metodologjisë së auditimit, si dhe përdorimin e teknologjive mbështetëse që fuqizojnë përputhshmërinë dhe cilësinë.

RSM Kosovo sh.p.k. konfirmon se, sipas njohurive dhe bindjes së saj më të mirë, sistemi i menaxhimit të cilësisë ka funksionuar në mënyrë efektive gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2024, duke ofruar një nivel të arsyeshëm sigurie se angazhimet tona janë kryer në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore, rregullatore dhe profesionale në fuqi.



Visar Morina
Partner Menaxhues



Sadik Berisha
Kryetar i Bordit

Deklarata e Pavarësisë

RSM Kosovo sh.p.k. konfirmon se ka zhvilluar dhe zbatuar politika dhe procedura të brendshme me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë me kërkesat e Kodit të Etikës së IESBA për Kontabilistët Profesionistë, i lëshuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC), si dhe me kërkesat përkatëse rregullative vendore. Këto politika dhe procedura janë hartuar për të mbështetur dhe ruajtur standardet më të larta të pavarësisë, integritetit dhe sjelljes etike në të gjitha angazhimet profesionale të firmës.

Gjatë vitit 2024, këto politika janë zbatuar dhe monitoruar në mënyrë të vazhdueshme, duke siguruar që të gjithë partnerët dhe anëtarët e ekipeve të angazhimeve të respektojnë standardet e kërkuara të pavarësisë dhe pajtueshmërisë etike. Si pjesë e këtij procesi, janë kryer rishikime të rregullta të brendshme dhe vlerësime të strukturuar për të identifikuar dhe adresuar në mënyrë të përshtatshme çdo kërcënim të mundshëm ndaj pavarësisë.



Visar Morina
Partner Menaxhues



Sadik Berisha
Kryetar i Bordit

Deklarata mbi edukimin e vazhdueshëm profesional

Gjatë vitit 2024, RSM Kosovo sh.p.k. ka zbatuar në mënyrë të vazhdueshme politikën e saj për edukimin e vazhdueshëm profesional, me qëllim të ruajtjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të kompetencave të auditorëve të licencuar dhe stafit të auditimit.

Kjo politikë është në përputhje me kërkesat e standardeve profesionale ndërkombëtare dhe rregulloreve vendore, duke synuar përditësimin e njohurive teknike, aftësive profesionale dhe vlerave etike të personelit tonë.

RSM Kosovo sh.p.k. konfirmon se gjatë vitit 2024, ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në politikat dhe procedurat e saj për edukimin e vazhdueshëm të partnerëve dhe stafit të përfshirë në angazhimet e auditimit.



Visar Morina
Partner Menaxhues



Sadik Berisha
Kryetar i Bordit

RSM KOSOVO SH.P.K

Str. Xhevdet Doda, Dukagjini Residence,
Hyrja B-C, Kati 2, Nr. B56,
Prishtina, Republic of Kosovo
T +383 45 666 888
Email: info@rsmks.com
www.rsmks.com

RSM KOSOVO SH.P.K is a member of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

The network is administered by RSM International Limited, a company registered in England and Wales (company number 4040598) whose registered office is at 50 Cannon Street, London EC4N 6JJ. The brand and trademark RSM and other intellectual property rights used by members of the network are owned by RSM International Association, an association governed by article 60 et seq of the Civil Code of Switzerland whose seat is in Zug.

© RSM International Association, 2025